



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:233971  
Datë: 23.01.2024  
Numri i dokumentit: 05226129

**PA1.nr.1834/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Pergjithshem**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Skender Çoçaj, anëtarë, me praktikantin gjyqesor Arben Arifi, si procesmbajtës në lëndën penale ndaj të akuzuarit R.D., nga Gjilani, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale Kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, për të vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.1025/22 të datës 08.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 22 Janar 2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.1025/22 të datës 08.11.2022, **VËRTETOHET.**

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.1025/22 të datës 08.11.2022, i akuzuari R.D., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 184 par.2 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 100 ( njëqind ) ditëve dhe për veprën penale Kanosja nga neni 181 par.4 e lidhur me par.2 të KPRK-së për të cilën i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njëzet) ditëve e në bazë të nenit 76 të KPRK-së i është shqiptuar dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve e me pëlqimin e të akuzuarit e në bazë të nenit 44 të KPRK-së, dënimi me burgim i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 1,800

(njëmijë e tetëqind) euro e te cilën gjobe eshte obliguar qe ta paguaje pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

Në dënimin e zëvendësuar me gjobë do t'i llogaritet edhe koha e qëndrimit ne arrest shtëpiak nga data 07.06.2022 deri me 04.07.2022.

I akuzuari është obliguar qe t'i paguaje shpenzimet e procedures penale qe dalin sipas llogarise përfundimtare te gjykatës, për ekspertizën mjeko-ligjore shumen prej 20 (njëzet) euro, ne emër te paushallit gjyqesor shumen prej 30 ( tridhjetë ) euro, e te gjitha keto ne afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

### **Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankese ka ushtruar :**

Prokuroria Themelore ne Gjilan, per shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar qe aktgjykimi i ankimuar i gjykates se shkalles se pare te ndryshohet, dhe te akuzuarit per veprën penale per te cilën eshte shpallur fajtor te i shqiptohet dënim me burgim më i lartë, e i cili dënim do të ishte proporcional me peshën e veprave penale të kryera, pasojat e shkaktuara me veprat penale si dhe rrezikshmërinë shoqërore te veprave penale.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u skjaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore ne Gjilan, me shkresën e vet PPA.II.nr. 1870/2022 të datës 29.11.2022 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën Prokurorisë Themelore ne Gjilan ta aprovoje si te bazuar, ndersa aktgjykimi i ankimuar i Gjykates se shkalles se pare te ndryshohet dhe te akuzuarit te i shqiptohet dënim me burgim efektiv.

Gjykata e Apelit mbajti seancen e kolegjit ne pajtim me nenin 390 paragrafi 1 te KPPRK-se, per te cilen nuk i ftoi palet ngase ne rastin konkret kemi te bëjmë me dënim me burgim te zëvendësuar ne dënim me gjobë dhe pretendimet ankimore janë vetëm lidhur me sanksionin penal andaj prezenca e paleve nuk eshte e obliguar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore te Prokurorisë Themelore ne Gjilan, dhe gjeti se:

#### **- Ankesa nuk eshte e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës të njejtin e shqyrtoi në këtë aspekt sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

As gjendja faktike nuk ka qenë objekt shqyrtimi ngase i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar të datës 08.11.2022 në bazë të nenit 248 të KPRK-së ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilen eshte akuzuar, i cili pranim eshte bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet që përmban aktakuza dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike del që në rastin konkret drejtë është aplikuar edhe ligji penal.

Sa i perket vendimit mbi sanksionin penal Prokuroria Themelore ne Gjilan, me ankesë pretendon se Gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit te dënimit me burgim e me pëlqimin e të akuzuarit të zëvendësuar ne dënim me gjobë, i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë per veprën penale te kryer, pendimin, keqardhjen, premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra penale mirëpo nuk i ka vlerësuar rrethanat renduese si faktin se veprat penale janë kryer me dashje dhe se i akuzuari ka mbajtur thikë në dorë me rastin e kanosjes, e sikur këto rrethana te ishin vlerësuar ne menyre te duhur eshte dashur qe te akuzuarit te i shqiptoje dënim më të lartë me burgim e i cili do te ishte ne proporcion me shkallen e rrezikshmerise, menyren e kryerjes si dhe pasojen e shkaktuar dhe se me denimin e shqiptuar nga ana e gjykates se shkalles se pare nuk mund te arrihet qellimi i denimit i parapare me nenin 38 te KPRK-se, andaj ka propozuar qe ankesa e Prokurorisë Themelore ne Gjilan te aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosoves, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore ne Gjilan lidhur me sanksionin penal per shqiptimin e dënimit më të lartë me burgim dhe pas vleresimit te njejtës, dhe duke i patur parasysht rrethanat e cekura më lartë dhe rrethanat e rastit konkret, Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata e shkalles se pare drejte dhe ne menyre te plote i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese nga neni 69 dhe 70 te KPRK-se te cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, andaj konstaton se denimi i shqiptuar me burgim e me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësuar ne dënim me gjobë nga ana e gjykates se shkallës së parë eshte në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale të kryera, andaj e refuzoi si te pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore ne Gjilan për shqiptimin e dënimit më të lartë me burgim, duke e vërtetuar aktgjykimin e Gjykates se shkalles se pare, e me bindje se me denimin e shqiptuar nga ana e Gjykates se shkalles se pare, do të arrihet qellimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i saj, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.1834/22 më 22.01.2024**

**Procesmbajtësi**  
**Arben Arifi**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Abdullah Ahmeti**

**Kryetar i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Skender Çoçaj**